

**STUDIM/PROJEKTIMI DHE MASA  
INXHINIERIKE – URA E VIROIT,  
GJIROKASTËR**

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË  
NDIKIMIT NË MJEDIS**

1. HYRJE	1
2. TË DHËNA MBI HARTUESIN E RAPORTIT	1
3. SHËNIME MBI VLERËSIMIN E RAPORTIT TË VNM	1
4. KUADRI POLITIKO-ADMINISTRATIV DHE LIGJOR	1
4.1 KUADRI POLITIKO-ADMINISTRATIV	1
4.2 BAZA LEGJSLATIVE	2
5. PËRMBAJTJA E RAPORTIT	5
6. KUADRI LIGJOR DHE STATUSI I ZONËS NË STUDIM	6
7. TË DHËNA PËR MJEDISIN EKZISTUES TË ZONËS KU ZBATOHET PROJEKTI	6
Të dhëna gjeografike	6
Përshkrimi i mbulesës bimore	6
Informacion për praninë e burimeve ujore	8
Të dhëna klimatike	8
Turizmi	9
Të dhëna demografike	9
Të dhëna mbi trashëgiminë arkitektonike dhe historike	9
Të dhëna mbi peisazhin dhe topografinë	9
8. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	9
9. ANALIZA E NDIKIMEVE MJEDISORE	14
9.1 PËRSHKRIM SINTETIK I GJENDJES SË MJEDISIT	14
9.2 PËRSHKRIM SINTETIK I MODIFIKIMEVE KRYESORE TË PARASHIKUAR	14
Efektet mbi klimën dhe atmosferën	14
Efektet mbi karakteristikat gjeologjike dhe hidrogeologjike	14
Efektet mbi tokën	14
Efektet mbi përdorimin e tokës dhe aktiviteteve antropike	14
Efektet mbi bimësinë	15
Efektet mbi faunën	15
Efektet mbi peisazhin	15
9.3 IMPAKTET SI PASOJË E IMPIANTIT DHE MENAXHIMIT TË KANTIERIT	16
Atmosfera	18
Zhurmat dhe vibrimet	18
Mbetjet	18
Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative	19
Shtirja e mundshme hapësinore e ndikimit negativ në mjedis	20
Rehabilitimi i mjedisit dhe kthimi i tij në gjendjen e mëparshme	20
9.4 MASAT ZBUTËSE KUNDËR IMPAKTEVE TË PRODHUAR NGA KANTIERI	20
9.5 FAZA OPERATIVE	22
Zhurma	22
Ajri	22
Vibrimet	23
Ujërat	23
10. PASIGURITË NË VLERËSIMIN E NDIKIMIT	23
11. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I PERFORMANCËS MJEDISORE	23
12. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR (PMM)	23
13. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMEVE GJATË FAZËS SË KANTIERIT	24
14. BAZA LIGJORE E MONITORIMIT	25
15. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	27

## 1. HYRJE

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis bazohet në rëndësinë e hartimit të një studimi urbanistik dhe mjedisor me standarde bashkëkohore, duke mbajtur parasysh pasuritë natyrore dhe njerëzore të zonës në studim, vlerat e veçanta të tyre, si dhe kërkesat e pronarëve të zonës. Identifikimi i efekteve negative dhe pozitive dhe përcaktimi i masave zbutëse është bërë duke patur parasysh ruajtjen e interesave të investitorëve, shfrytëzimin racional të resurseve natyrore, si dhe përputhjen e zhvillimit ekonomik e social të zonës me kërkesat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis mund të përcaktohet si një procedurë e hapur ndaj pjesëmarrjes së publikut e cila, në vijim të kërkimit me karakter tekniko-shkencor dhe ndërdisiplinor, jep një gjykim paraprak lidhur me përputhshmërinë mjedisore të një projekti (publik ose privat), realizimi i të cilit mendohet se mund të shkaktojë efekte të rëndësishme në mjedisin e konsideruar globalisht.

Objekti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përshkruhet në nenin 3 të Direktivës nr. 85/377/CEE: “ VNM individualizon, përshkruan dhe vlerëson, në mënyrë specifike, për secilin rast në veçanti....efektet direkte dhe indirekte të një projekti mbi faktorët e mëposhtëm: njeriu, fauna, flora; toka, ajri, klima dhe peisazhi; ndërveprimin midis faktorëve të mësipërm dhe të mirave materiale dhe pasurisë kulturore “. Neni i mësipërm evidenton unitaritetin e kompleksit ekologjik: nga ky unitaritet rrjedh që parametri i VNM nuk është vetëm respektimi i disiplinave sektoriale, i planeve dhe i standarteve, por vlerësimi i efekteve globalë të një ndërhyrjeje sipas metodave tekniko-shkencore të kërkimit. Qëllimi i disiplinës së VNM, është ai i “ pajtimit të kërkesave të zhvillimit ekonomik dhe prodhues me ato të ruajtjes së pasurisë mjedisore, nëpërmjet zgjedhjes së një kompromisi, i cili të prekë sa më pak të dytën në favor të të parit “. Gjithësesi, duhet mbajtur parasysh që, vlerësimi i një vepre publike ose me interes publik, do të thotë edhe gjykim i vlerës së saj në perspektivën e interesit kolektiv me kritere dhe informacione *ad hoc*, përgjithësisht të ndryshëm nga ata të përdorur për projektimin e ndërhyrjes.

## 2. TË DHËNA MBI HARTUESIT E RAPORTIT

Raporti i mëposhtëm është hartuar me kërkesën e zhvilluesit të sipërfaqes së ndërtimit për zbatimin e projektit: **Studim/Projektimi dhe masa inxhinierike – Ura e Viroit, Gjirokastrë.**

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është përgatitur nga Ing. Alfred Lako, i pajisur me Çertifikatë nga Ministria e Mjedisit, me Vendim nr. 4, Nr. 127 Regj, datë 12.05.2005 dhe me Liçencë nga QKL LN-7564-03-2014, Kodi III.2.A (1 + 2).

## 3. SHËNIME MBI VLERËSIMIN E RAPORTIT TË VNM

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis, për vetë natyrën e tij, përmban vlerësime lidhur me ndikimet e projektit të propozuar, disa prej të cilave janë pozitive dhe disa të tjera negative. Një gjykim selektiv, ose jashtë kontekstit, mund të çojë në përfundime të gabuara përsa i përket qëllimit të raportit.

Autori kërkon që të interesuarit, përveç këtij raporti, t’i referohen edhe Relacionit Teknik, ku janë dhënë edhe propozimet e projektit për objektin në studim.

## 4. KUADRI POLITIKO-ADMINISTRATIV DHE LIGJOR

### 4.1. KUADRI POLITIKO-ADMINISTRATIV

Administrimi dhe mbrojtja e mjedisit janë pjesë përbërëse e Legjislacionit Shqiptar; neni 59, pika d e Kushtetutës, përcakton:

“ Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe përgjegjësisë private, synon:

- .....
- d) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. “

Legjislacioni kërkon që kondicionet urbane të shfrytëzohen në përputhje me principe të bazuara. Në kapitullin II, “ Politikat mjedisore “ përcaktohen:

- Politika shtetërore mjedisore, e cila përcakton pozicionin e mjedisit në legjislacion, vendin e strategjive të sektorëve kombëtarë dhe planet lokale si pjesë e politikës mjedisore dhe përcakton organizmat të cilët do të administrojnë këto politika;
- Programet dhe strategjitë mjedisore, të cilat përcaktojnë Planin e Veprimit Kombëtar të Mjedisit (PVKM), i cili duhet të hartojë një raport mjedisor në zbatimin e PVKM për Këshillin e Ministrave;
- Planet lokale mjedisore, ku kërkohet që pushtetet vendore të zhvillojnë Planet Lokale të Veprimit të Mjedisit (PLVM) duke përdorur organizmat kombëtare për të ofruar të dhëna dhe mbështetje teknike, për pushtetet lokale që të lidhen me publikun, OJQ dhe biznesin për zhvillimin e planeve, dhe kryetarët e bashkive të raportojnë në Këshillat e Rretheve për zbatimin e planeve në fund të çdo viti.

#### 4.2. BAZA LEGJISLATIVE

Legjislacioni mbi të cilin bazohet mbrojtja e mjedisit, është fuqizuar relativisht me shpejtësi në Shqipëri. Ligji i parë për Mbrojtjen e Mjedisit doli në vitin 1993 dhe u amendua në vitin 1998. Procedura e VNM-së përshkruhet në Ligjin Nr. 10440, dt. 07.07.2011 “ Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis “ (pas shfuqizimit të Ligjit Nr. 8990 dt. 23.01.2003), ndërsa konceptet kryesore dhe pjesëmarrësit në proces i përcakton Ligji “ Për Mbrojtjen e Mjedisit ” (Nr. 8934 dt. 05.09.2002), në kapitullin IV të tij, ligj i cili është shfuqizuar që prej qershorit të 2011 pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 10431, dt. 09.06.2011 “ Për Mbrojtjen e Mjedisit ”. Në kreun II të tij, paraqiten nën pas neni parimet kryesore të mbrojtjes së mjedisit që janë marrë parasysh në hartimin e këtij raporti të VNM nga specialisti dhe audituesi mjedisor:

1. Parimi i zhvillimit të qendrueshëm;
2. Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake;
3. Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore;
4. Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit;
5. Parimi i qasjes së integruar;
6. Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit;
7. Parimi “ ndotësi paguan ”;
8. Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut;
9. Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit.

Në Ligjin Nr. 10431, dt. 09.06.2011 “ Për Mbrojtjen e Mjedisit ”, në Kreun IV (Mbrojtja e mjedisit në procesin e planifikimit), përcaktohet qartë në nenin 24, që VSM kryhet për planet e planifikimit dhe rregullimit të territorit.

Në Ligjin Nr. 10440, dt. 07.07.2011, Kreu II (Procedurat e Vlerëimit të Ndikimit në Mjedis), thuhet:

## Neni 7

### **Procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis**

1. Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse, nga autoriteti përgjegjës, për zhvillimin ose jo të projektit.
2. Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:
  - a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
  - b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.
3. Dokumenti bazë, ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:
  - a) raporti paraprak i VNM-së, për projektet e shtojcës II;
  - b) raporti i thelluar i VNM-së, për projektet e shtojcës I.

---

## Neni 8

### **Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të VNM-së**

Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis janë:

- a) projektet e listuara në shtojcën II, bashkëlidhur;
- b) çdo ndryshim a shtesë në projektet e listuara në shtojcën I apo II, të licencuara paraprakisht, që mund të shkaktojë efekte të rëndësishme negative mbi mjedisin;
- c) projektet e listuara në shtojcën I, që ndërmerren, ekskluzivisht apo kryesisht, për testimin dhe zhvillimin e metodave ose produkteve të reja, të cilat nuk janë përdorur për më shumë se dy vjet;
- ç) projektet e listuara apo jo në shtojcën I ose II, që nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë apo nuk janë të nevojshme për administrimin e zonave veçanërisht të mbrojtura, por që, veçmas apo në bashkëveprim me plane dhe projekte të tjera, mund të shkaktojnë efekte negative të rëndësishme në këto zona. Në këtë rast, raporti paraprak i VNM-së përfshin edhe vlerësimin e ndikimeve të këtyre projekteve në atë zonë, duke marrë parasysh objektivat e ruajtjes dhe mbrojtjes së vendit ku do të zbatohet projekti.

## Neni 9

### **Projektet që i nënshtrohen procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis**

1. Procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen:
  - a) projektet e listuara në shtojcën I;
  - b) projektet, për të cilat vendimi i AKM-së parashikon nevojën e zbatimit të kësaj procedure.
2. Zhvilluesi, pavarësisht nga dispozitat e këtij ligji, mund të kërkojë mendim paraprak nga AKM-ja, nëse projekti që synon të zhvillojë është subjekt i këtij ligji.

Baza legjislative e përdorur:

Nr.	Ligji	Subjekti
1	Ligji Nr. 10431 datë 09.06.2011	Për mbrojtjen e Mjedisit
2	Ligji Nr. 10440, datë 07.07.2011	Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
3	Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011	Për lejet e mjedisit
4	Ligji Nr. 9362, datë 24.03.2005	Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve
5	Ligji Nr. 8897, datë 16.05.2002	Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
6	Ligji Nr. 9587, datë 20.07.2006	Për mbrojtjen e biodiversitetit
7	Ligji Nr. 81/2017	Për zonat e mbrojtura
8	Ligji Nr. 10081, datë 23.02.2009	Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë
9	Ligji Nr. 7875, datë 23.11.1994	Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë i ndryshuar me Ligjin Nr. 9219, datë 08.04.2004
10	Ligji Nr. 9385, datë 04.05.2005	Për pyjet dhe shërbimin pyjor, i ndryshuar me: Ligjin Nr. 9791 datë 23.07.2007
11	Ligji Nr. 8770, datë. 19.04.2001	Për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike i azhurnuar
12	Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007	Për administrimin e zhurmës në mjedis
13	Ligji Nr. 8766, datë 05.04.2001	Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin
14	Ligji Nr. 8756, datë 26.03.2001	Për emergjencat civile
15	Ligji Nr. 7643, 09.12.1999	Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror i ndryshuar
16	Ligji Nr. 9379, datë 28.04.2005	Për efikasitetin e energjisë
17	Ligji Nr. 9010 datë 13.02.2003	Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta i ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009
18	Ligji Nr. 10463, datë 22.09.2011	Për menaxhimin e integruar të mbetjeve
19	Ligji Nr. 9672, datë 26.10.2000	Për ratifikimin e konventës së Aarhusit “ Për të drejtën e publikut për të pasur informacion dhe përfshirjen në vendimmarrje, si dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit ”.
20	Ligji Nr. 9334, datë 16.12.2004	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos në konventën për ndryshimet klimatike (UNFC).

Vendime të Këshillit të Ministrave:

Nr.	VKM	Subjekti
1	VKM Nr. 395, datë 21.06.2006	Për miratimin e strategjisë dhe të planit të veprimit për zhvillimin e turizmit, kulturor dhe mjedisor
2	VKM Nr. 123, datë 17.2.2011	Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis.
3	VKM Nr. 587, datë 7.07.2010	Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike.
4	VKM Nr. 676, datë 20.12.2002	Për shpalljen e zonave të mbrojtura monument natyror
5	VKM Nr. 804, datë 04.11.2003	Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare që vihen në mbrojtje.

6	VKM Nr. 177, datë 31.03.2005	Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse.
7	VKM Nr. 435, datë 12.09.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë.
8	VKM Nr. 803, datë 04.12.2003	Për standardet e cilësisë së ajrit.
9	VKM Nr. 247, datë 30.04.2014	Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore
10	VKM Nr. 575, datë 24.06.2015	Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte
11	Vendim Nr. 99, datë 18.02.2005	Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve
12	VKM Nr. 114, datë 27.01.2009	Për marrjen e masave emergjente, për përmirësimin e situatës së sigurisë dhe të veprimtarive në instalimet, që shërbejnë për depozitimin transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre.
13	VKM Nr. 686, datë 29.07.2015	Për miratimin e rregullave, të përgjegjësiave e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore
14	VKM Nr. 395, datë 21.06.2006	Për miratimin e strategjisë dhe të planit të veprimit për zhvillimin e turizmit, kulturor dhe mjedisor
15	VKM Nr. 123, datë 17.02.2011	Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis.
16	VKM Nr. 587, datë 07.07.2010	Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike.

Udhëzime dhe Rregullore:

Nr.	Udhëzimi/Rregullorja	Subjekti
1	Udhëzimi Nr. 1037/1, datë 12.04.2011	Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore
2	Udhëzimi Nr. 8, datë 27.11.2007	Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara
3	Udhëzimi Nr. 6527, datë 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe mënyrat e kontrollit të tyre.
4	Rregullorja Higjeno-Sanitare datë 17.11.1997	Për pastrimin në zona urbane dhe rurale, administrimin dhe trajtimin e mbeturinave
5	Rregullore Nr. 1, datë 30.03.2007	Për trajtimin e mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre

## 5. PËRMBAJTJA E RAPORTIT

Ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis do të paraqesë një informacion të përmbledhur të projektit që do të realizohet, përshkrimin e zonës dhe të mjedisit fizik të saj, ndikimet pozitive dhe negative në mjedis të projektit dhe masat që zbatuesi do të marrë për plotësimin e kriterëve të nevojshme për mbrojtjen dhe administrimin sa më racional të mjedisit.

## **6. KUADRI LIGJOR DHE STATUSI I ZONËS NË STUDIM**

Zona në studim është nën administrimin e Bashkisë Gjirokastrë. Nga pikëpamja funksionale, kjo zonë është klasifikuar si zonë jo urbane, e destinuar kryesisht për zbatimin e projektve të infrastrukturës së transportit.

Projekti i zbatimit:

**Studim/Projektimi dhe masa inxhinierike – Ura e Viroit, Gjirokastrë**, në bazë të Ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “ Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis “, Shtojca II:

Projektet që i nënshtrohen procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis:

10) Prodhime infrastrukturore

d) Ndërtim rrugësh, portesh dhe instalimesh për porte, duke përfshirë dhe portet e peshkimit (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I),

bën pjesë në këtë kategori projektesh.

## **7. TË DHËNA PËR MJEDISIN EKZISTUES TË ZONËS KU ZBATOHET PROJEKTI**

### **TË DHËNA GJEOGRAFIKE**

Zona në studim bën pjesë në njësinë fiziko-gjeografike të krahinës malore jugore. Ajo ka një lartësi mesatare rreth 190 m mbi nivelin e detit dhe shtrihet në veri të qytetit të Gjirokastrës, duke pasur akses me qytetin nëpërmjet objektit që do të rikonstruktohet.

Kjo zonë ndodhet nën administrimin e Bashkisë Gjirokastrë.

Gjirokastra është e vendosur në faqen e Malit të Gjerë, në shpatet verilindore të tij dhe në krahun e majtë të luginës së lumit Drino. Rrëza dhe faqja e malit ku ndodhet është pothuajse e zhveshur, pa bimësi. Duke qenë e tillë, në dimër kur reshjet janë të bollshme, nëpër pjerrësi lëshohen përrenj të rrëmbyer me ujëra të shumta. Ato vijnë deri në qytet. Vetë qyteti ka shumë përrenj dhe çdo lagje ndahet nga njëra-tjetra me një të tillë. Gjirokastra ka qenë dhe vazhdon të mbetet një nga qendrat kryesore të pjesës jugore të Shqipërisë. Ajo ka pasur lidhje jugore me Janinë, me bregdetin shqiptar, Vlorën, dhe pellgun e Delvinës. Nëpërmjet grykës së Këlcyrës lidhet me qendra të tjera të Shqipërisë jugore. Është e lidhur gjithashtu me Kurveleshin e Sipërm dhe të Poshtëm, Lunxhërinë, Dropullin e Poshtëm, Pogonin, Zagorinë etj. Mali i Gjerë në rrëzë të së cilit është vendosur Gjirokastra, e ndan qytetin nga bregdeti.

Nga veriu qyteti Gjirokastrë kufizohet me fshatin Mashkullorë, nga jugu me Lazaratin, nga lindja me lumin Drino dhe me fshatrat e Lunxhërisë dhe nga perëndimi me Malin e Gjerë. Për shkak të rritjes së shpejtë urbane të Gjirokastrës, pas rënies së komunizmit, ka toponime të reja. Gjirokastra ka këto lagje: Cfaqë, Dunavat I, Dunavat II, Hazmurat, Manalat I, Manalat II, Meçite, Palorto, Pazari i Vjetër, Pllakë, Teqe, Varosh, Zinxhire.

### **PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE**

Ndër tipet kryesore të mbulesës bimore në zonë mund të përmenden:





**Figura 1. Foto e segmentit rrugor ekzistues**

- Pyjet aluvionale përgjatë brigjeve të lumit;
- Pyjet dhe shkorreta mesdhetare (formacionet e makjes);
- Toka bujqësore.

### **Pyjet aluvionale**

Brigjet e lumit të Vjosës, shpesh me shtrat të gjerë, janë të mbuluar me vegjetacion hidro-higrofil.

Shoqërimet bimore kryesore të pyjeve aluvionale u përkasin klasave *Alno-Populetea* dhe *Salicetea purpurea*.

Përbërësit kryesore të pyjeve aluvionale të zallishteve të lumit të Vjosës janë: *Platanus orientalis*, *Alnus incana*, *Populus alba*, *Salix alba*, *Salix purpurea*, *Salix amplexicaulis*, etj.

Në ujërat me rrjedhje të shpejtë marrin prioritet shoqërimet me *Platanus orientalis* apo të ashtuquajturat rrapishte. Krahas këtyre formacioneve të dominuara nga rrapit (*Platanus orientalis*) vihen re edhe formacione të dominuara nga *Populus alba*.

Në katin shkurror të këtyre pyjeve vërehen llojet bimore: *Salix elaeagnos*, *Tamarix parviflora*, *Rubus ulmifolius*, *Crataegus monogyna*, *Rosa sempervirens*, *Vitex agnus castus* etj.

Në ujërat me rrjedhje të qetë, në moçalishte buzë ujërave me substrat lymor dhe toka eutrofike marrin prioritet shoqërimet me *Alnus incana* (asociacioni *Alnetum-incanae*), *Alnus glutinosa*, *Salix alba*. Elementë dominantë të këtij shoqërimi janë *Alnus incana*, *Ulmus minor*, *Populus alba* dhe *Fraxinus ornus*.

Gjithashtu në këto rrjedha janë të pranishme shoqërimet bimore të klasës *Phragmitetalia* me asociacionin kryesor *Phragmites australis* si dhe shoqërimet bimore të shavarit (*Typha angustifolia*). Një asociacion i tillë tregon një plasticitet të lartë ekologjik.

### **Pyjet dhe shkorretat mesdhetare**

Brezi i pyjeve dhe shkorretave mesdhetare përfaqson formacionin bazë dhe me përhapjen më të madhe. Shoqërimi i *Quercetum cocciferii* formon formacionin shkurror të dominuar nga pralli. Shoqërimi i *Arbuto-Ericetum*, i mares me shqopen, është formacioni bimor me l përhapur në këto lugine.

Formacione të pyjeve të *Quercus frainetto* e *Quercus cerris* si dhe stadeve të degradimit të tyre (*Carpinus orientalis*, *Ostrya carpinifolia*) takohen në një pjesë të konsiderueshme, deri në 1.200 m lartësi mbi nivelin e detit, por rrallëherë në gjendje të mirë. Nga pikëpamja fitosociologjike këto pyje i përkasin rendit *Quercetalia pubescentis* dhe aleancës *Quercion*

*frainetto-cerris*, *Ostrya-Carpinion orientalis*. Pylli natyror dominohet kryesisht nga *Quercus cerris*, i shoqëruar nga *Quercus pubescens* apo *Quercus frainetto*.


Edhe flora barishtore paraqitet e pasur në këtë zonë. Ndër llojet më të pranishme të zonës përmendim: *Origanum vulgare*, *Psoralea bituminosa*, *Trifolium campestre*, *Dorycnium pentaphyllum*, *Brachypodium ramosum*, *Campanula glomerata*, *Dictamnus albus*, *Micromeria Juliana*, *Micromeria graeca*, *Bellis perennis*, *Dactylis glomerata* etj.

### Tokat bujqësore

Tokat bujqësore ndeshen përgjatë pjesës më të madhe të rrugës. Në shumicën e rasteve kultivohet misër, grurë, perime dhe pemë frutore. Produktiviteti i tyre paraqitet i lartë si rezultat i aluvioneve lumore.

### INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQËN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË TIJ

Rrjedhja sipërfaqësore përfaqsohet nga lumi i Drinos. Ky lumë është një nga lumenjtë më të mëdhenj të Shqipërisë së Jugut, i cili dallohet për gjatësinë e tij (272 km). Përgjatë këtij seksioni, Vjosa ka 20 degëzime (3 lumenj dhe 17 përrenj) kryesisht në anën e djathtë të rrjedhës së saj. Pjesa më e madhe e lumenjve dhe përrenjve që përfundojnë në Vjosë i kanë basenet e tyre të krijuara nga formacione terrigenus të padepërtueshme nga rrjedha e ujit kështu që ato dallojnë për një koeficient të lartë rrjedhjeje, dhe nga shkarkime të konsiderueshme të ujit gjatë sezonit.



**Figura 2. Harta e baseneve ujëmbledhës**

### TË DHËNA KLIMATIKE

Sipas klasifikimit klimatik të Shqipërisë, zona në studim, hyn në nënzonën klimatike mesdhetare kodrinore juglindore me drejtim veriperëndimor dhe juglindor, e cila i nënshtrohet në mënyrë aktive ndikimit të detit Adriatik dhe më pak atij Jonian. Këtë drejtim ka dhe qarkullimi i erërave gjatë vitit. Në gjysmën e ftohtë mbizotëron juglindja dhe në gjysmën tjetër veriperëndimi.

Vend matjet meteorologjike: Gjirokastra 193 m, Goranxia 210 m dhe Jorgucati 243 m mbi nivelin e detit.

## TURIZMI

Turizmi ka marrë zhvillim të madh pas viteve 90'. Shumë të huaj vizitojnë Gjirokastrën për vlerat arkitekturale të ndërtimit të shtëpive me gur e çatime me dërrasa.

Turisti në Gjirokastrë mund të vizitojë Qendrën Historike me Pazarin dhe objektet e tij karakteristike si dhe Kështjellën ku përveç Muzeut të Armëve të ofron pamje shumë të bukura të qytetit nga lart. Në Gjirokastrë vizitori mund të vizitojë edhe Muzeun Etnografik, Shtëpitë karakteristike të Zekatëve, Skendulatëve, Babametos, Kadaresë, Hani i Zagorisë, Dulajve, etj.

Në Luginën e Drinos gjenden disa site arkeologjike ku më të rëndësishmit janë Antigonea, rreth 14 km nga Gjirokastra dhe siti romak i Adrianopolit shek. ps.k. në afërsi të fshatit Sofratikë. Mbresëlënëse dhe me vlera historike e arkitektonike janë edhe Kishat paleokristiane të Shën Marisë në Labovë dhe Peshkëpi.

Për të apasionuarit e natyrës me shumë vlera janë Parqet natyrore si Viroit, Sotirës, Ujit të Ftohtë Tepelenë, Hotova, Pllaja e Çajupit (1.200 m), Ujërat Termale të Benjës (Përmet) si dhe kanionet e Lumit të Suhës, Zagorisë dhe Vjosës.

Me shumë vlera për zhvillimin e rajonit të Gjirokastrës do të ishte edhe riaktivizimi i Aeroportit që ndodhet në pjesën e poshtme të qytetit në qendër të luginës së Drinos. Ky aeroport i ndërtuar në vitet '30 nga italianët, shërbente si një pikë lidhjeje e Gjirokastrës me qendrat e tjera të Shqipërisë. Sot aeroporti është i papërdorshëm.

Gjirokastra ka pamje të mrekullueshme e piktoreske. Shtëpitë karakteristike dhe arkitektura e veçantë i japin asaj pamjen e një anije në luginën e Drinos.

## TË DHËNA DEMOGRAFIKE

Zona pranë objektit dallohet për një intesitet demografik relativisht të lartë. Popullsia përreth është autoktone dhe pjesërisht e ardhur gjatë viteve të tranzicionit. Objekti ndodhet rreth 4 km larg qendrës së Gjirokastrës.

## TË DHËNA MBI TRASHËGIMINË ARKITEKTONIKE DHE HISTORIKE

Parku i Viroit është një nga atraksionet natyrore më të bukura afër qytetit të Gjirokastrës. Shihet në hyrje të Gjirokastrës nga rruga Tepelenë - Gjirokastrë. Viroi është një burim ujqor karstik, që është plot me ujë në dimër dhe pranverë por thahet në verë. Kjo shpjegohet me fenomenin sifon, kur ujërat nëntokësore mblidhen në një rezervuar poshtë burimit. Burimi i shpellës është i gjatë rreth, 6 ÷ 8m, dhe i gjerë 3 ÷ 4 m, me një thellësi deri në 22 m. Temperatura e ujit është e rreth, 13 ÷ 14 °C. Pranë burimit gjendet një bimësi e pasur. Shumë zhytës janë kurioz të eksplorojnë botën nënujqore të Viroit. Për shkak të thellësisë të konsiderueshme, liqeni i kulluar i Viroit ofron pamje mahnitëse.


Liqeni i Viroit është shpallur si një **zonë e mbrojtur** në vitin 1982. Shpella nëntokësore e Viroit ka një thellësi prej 249 m dhe është e rrethuar nga pisha të egra.

## TË DHËNA MBI PEISAZHIN DHE TOPOGRAFINË

Sipërfaqja në të cilën do të ngrihet objekti, bën pjesë në një zonë tipike jo urbane, e modifikuar prej kohësh nga aktiviteti antropik. Terreni është fushor, pa tipare të veçanta morfologjike.

## 8. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Segmenti ekzistues rrugor, me gjatësi rreth 400 m, është pjesë e segmentit rrugor SH4.

Ai shtrihet në krah të Liqenit të Viroit. Është pjesë e aksit rrugor nacional Gjirokastrë - Tepelenë me trafik të konsiderueshëm, pasi është segment që lidh Shqipërinë me Greqinë, 



duke qenë kështu pjesë e rrjetit ndërkombëtar. Nga ana planimetrike, segmenti ekzistues rrugor paraqitet me dy kthesa të njëpasnjëshme me kahe të kundërta kthimi, me rreze,  $R = 120$  m nga ana e Tepelenës dhe  $R = 180$  m nga ana e Gjirokastrës. Nga ana altimetrike rruga ka një pjerrësi të vogël gjatësore,  $i_{gj} = 1 \div 2 \%$ .

Ky segment rrugor ka dy problematika kryesore nga pikëpamja funksionale:

**Së pari**, ndonëse rruga i ka shtresat asfaltike në gjendje të mirë, ajo nuk plotëson kriteret e kategorisë së rrugës, funksionin e të cilës ajo kryen. Rruga ka dy vija kalimi me gjerësi  $b = 3$  m dhe gjerësi të përgjithshme  $B = 6$  m, nuk ka bankina, por kufizohet me parapete muri në të dy anët e saj, gjë e cila vështirëson lëvizjen e mjeteve, veçanërisht gjatë shkëmbimit të tyre.

Mungesa e bankinave në të dy krahët, shkakton humbjen e përqëndrimit të shoferit dhe për rrjedhojë të ul ndjeshëm sigurinë e rrugës.

Rruga në të dy anët e saj (nga Gjirokastra dhe Tepelena), lidhet me rrugë që kanë seksion të ndryshëm dhe ndryshimi i tij nuk është realizuar me një gjatësi rakorduese, duke e kthyer këtë segment në një pikë rreziku. Rruga ekzistuese ndodhet mbi trupin e Digës së Liqenit të Viroit.

**Së dyti**, bllokimi i rrugës në kohë reshesh për shkak të mungesës së kapacitetit të shkarkimit të ujërave të liqenit dhe përroit në anën veriore të liqenit të Viroit. Kjo sipas analizës tonë ndodh për dy arsye:



*Figura 3. Pamje nga ura ekzistuese*

- Nga mosorientimi i shkarkuesit të liqenit të Viroit;
- Nga seksioni i vogël i urës ekzistuese automobilistike,  $B = 6 \times 3$  m;

Në rastet e reshjeve me intensitet ndodh ngritja e nivelit të ujërave të liqenit mbi nivelin e rrugës duke vështirësuar qarkullimin ose duke bllokuar atë.

Si pasojë e kësaj situatë, ka ndoshtur edhe gërryerja e shtratit pas dhe para urës ekzistuese, gjë e cila ka rrezikuar dhe shembjen e ballnave ekzistues. Ura ekzistuese është tip solete e ndërtuar me elemente të parapërgatitur. Në pjesën e poshtme të soletës së saj, kemi ekspozim dhe korrodinim të çelikut.


Qëllimi kryesor i hartimit të këtij projekti është:

**Studimi dhe hartimi i një projekti të mirëfilltë për një segment rrugor prej rreth 400 m dhe jo limituar së bashku me projektimin dhe marrjen e masave inxhinierike për mbrojtjen e tij nga lumi dhe plotat e ndryshme si dhe kthimin e tij në një segment të kategorisë C2, me gjerësi të korsive  $B = 2 \times 3.5\text{m}$  duke projektuar dhe zgjerimin e tij.**

Përveç këtij objekti, realizimi i projektit do të bëjë të mundur njëkohësisht dhe arritjen e disa objektivave të tjera si:

- Rritja e shpejtësisë dhe sigurisë së lëvizjes.
- Krijimin e kushteve më të mira për njerëzit që shkojnë të vizitojnë liqenin.
- Rritjen e pastërtisë së ajrit.

Nga rezultatet e studimit është nxjerrë profili tërthor tip sipas projektit të hartuar nga Konsulenti i cili i përket rrugës ndërrurbane dytësore, kategoria C2 me tregues kryesorë si më poshtë:



- Rrugë ndërrurbane dytësore;
- Kategoria C2;
- Kapaciteti për korsitë 600 mjet njësi/24orë;
- $VD_{min} = 60$  km/orë;
- $VD_{max} = 100$  km/orë;
- Limiti i shpejtësisë 90 km/orë.


**Figura 4. Seksioni tërthor tip**

Në projektin e zbatimit është dhënë shtrirja në plan dhe altimetria e rrugës. Po kështu në planimetri jepen të dyja ndërprerjet rrugore, si ajo nga ana e Gjirokastrës (emërtuar Ndërprerja Rrugore " NRr A "), ashtu dhe ndërprerja rrugore nga ana e Tepelenës (emërtuar Ndërprerja Rrugore " NRr B "). Këto nyje janë konsideruar ndërprerje rrugore të formës bazë I: " Nyja T ose kryqëzimi tek karrexhatat teke ".


Parametrat e tjerë të projektimit për këtë rast plotësojnë kërkesat e normave dhe janë:

- $R1 = R2 = 300$  m;

- $i = 0.6\%$  (pjerrësia gjatësore).



**Figura 5. Zgjidhja e segmentit rrugor te Ura e Viroit, Gjirokastër**



**Figura 6. Orografia**






Figura 7. Seksioni tip i urës në aksin e ri të rrugës




Figura 8. Seksioni tip i urës në aksin ekzistues

## **9. ANALIZA E NDIKIMEVE MJEDISORE**

Analiza e ndikimeve mjedisore është kryer për të dyja fazat e projektit: faza ndërtimore (kantier ndërtimi) dhe faza e operimit (rrugë automobilistike).

### **9.1 PËRSHKRIM SINTETIK I GJENDJES SË MJEDISIT**

Zona objekt i ndërhyrjes është e vendosur në dalje të qytetit të Gjirokastrës. Ajo rezulton e rrafshët dhe me karakteristika të rëndësishme nga ana **hidrologjike dhe hidrogeologjike**, për shkak të pranisë së trupave dhe rrjedhave ujore.

Duke qenë se objekti ndodhet në zonë jo urbane, **ka prani të bimësisë natyrore**, por që duke patur parasysh natyrën e kufizuar të ndërhyrjes, mundësia e ndikimit nga aktivitetet e ndërtimit të objektit është e vogël.

### **9.2 PËRSHKRIM SINTETIK I MODIFIKIMEVE KRYESORE TË PARASHIKUAR**

#### **Efektet mbi klimën dhe atmosferën**

Efektet e shkaktuar nga zbatimi mbi klimën, ose më mirë mbi mikroklimën, do të jenë nul ose të parëndësishëm, meqenëse nuk parashikohet asnjë ndryshim në nivel mikroklimatik të indikatorëve të ndryshëm.

Efektet e shkaktuar nga zbatimi i punimeve mbi cilësinë e ajrit mund të konsiderohen të lehta, të kufizuar në periudhën e zbatimit të ndërhyrjes dhe konsiderohen si përkeqësime të lokalizuara dhe të përkohëshme të cilësisë së ajrit për shkak të emetimeve gazore të tipeve të ndryshëm të prodhuara nga mjetet mekanikë kryesisht gjatë punimeve të gërmimit dhe lëvizjes së dheut si dhe gjatë stokimit dhe transportit të materialeve.

#### **Efektet mbi karakteristikat gjeologjike dhe hidrogeologjike**

Ndërhyrjet e ndërtimit të urës nuk parashikojnë lëvizje të ndjeshme të dheut, duke kufizuar kështu mundësinë e rreziqeve potencialë të erozionit për objektin dhe aktivitetet që do të vendosen në zonë.

#### **Efektet mbi tokën**

Punimet e lëvizjes së dheut nuk do të kenë efekt të dukshëm, duke modifikuar vetëm në një pjesë të vogël gjendjen aktuale të vendit.

#### **Efektet mbi përdorimin e tokës dhe aktivitetet antropike**

Punimet e nevojshme për realizimin e objektit nuk mbartin asnjë modifikim të destinacionit të përdorimit të tokës dhe organizimit të zonës.

Të gjitha punimet do të kryhen me kujdesin e duhur, dhe në rastin kur do të zbulohen elementë arkeologjikë, do të njoftohen autoritetet përkatëse.



## Efektet mbi bimësinë

Nuk parashikohen efekte të veçanta pozitive ose negative mbi bimësinë.

## Efektet mbi faunën

Zona nuk paraqet karakteristika të tilla që të mund të përbëjë një vend ku fauna mund të gjejë kushte ideale për jetën dhe riprodhimin. Kjo kryesisht për shkak të shtrirjes dhe aktivitetëve antropike. Prania rastësore e ndonjë kafshe të egër (kryesisht insekte, reptilë ose brejtës) nuk konsiderohet e rëndësishme nga pikëpamja e efekteve duke qenë zona një habitat jo natyror për jetën e tyre.

## Efektet mbi peisazhin

Nuk parashikohen efekte negative mbi peisazhin.

**Tabela 1. Faktorët potencialë të trysnisë mjedisore**

Faktorët	Faza e kantierit	Faza operative
<b>Atmosfera</b>	Emetimet e makinerive në funksionim	Emetime nga impiantet në shërbim
	Prodhimi i pluhurave	Emetime nga impiantet në shërbim
<b>Mjedisi ujqor</b>	Infiltrim i mundshëm i emetimeve ndotëse në ujërat nëntokësore	Emetime nga impiantet në shërbim
<b>Toka dhe nëntoka</b>	Derdhje e substancave ndotëse	
<b>Zhurmat dhe vibrimet</b>	Emetime akustike të makinerive në funksionim	Nuk parashikohet prodhim zhurmash
	Vibrime të makinerive në funksionim	Nuk parashikohet prodhim vibrimesh
<b>Ndriçimi</b>	-	Emetime ndriçimi rastësorë
<b>Peisazhi</b>	-	-
<b>Trafiku i automjeteve</b>	Interferencë me trafikun si pasojë e mjeteve të kantierit	Trafik automjeteve rastësor
<b>Energjia</b>	Konsum nga impiantet e kantierit	Konsum për funksionimin e objektit
<b>Mbetjet</b>	Prodhim mbetjesh ndërtimore	

Ndërmjet faktorëve të presionit mjedisor të paraqitur në tabelën e mësipërme, më poshtë janë analizuar ata të lidhur me fazën e kantierit dhe realizimit të objektit të projektuar:

- Impaktet si pasojë e impiantit dhe menaxhimit të kantierit;
- Zhurmat;
- Qarkullimi dhe trafiku.

### 9.3 IMPAKTET SI PASOJË E IMPIANTIT DHE MENAXHIMIT TË KANTIERIT

Nga një shqyrtim paraprak i ndërhyrjes së projektuar, rezultojnë me impakt të veçantë mbi territorin dhe njerëzit disa faza të lidhura me realizimin e saj. Në tabelën e mëposhtme, jepen faktorët e presionit mjedisor hipotetikë.

**Tabela 2. Impaktet potencialë për fazën e kantierit**

Komponentët mjedisorë	Faktorët e presionit
<b>Atmosfera</b>	Emetime të makinerive në funksionim Prodhim pluhurash
<b>Mjedisi ujqor</b>	Infiltrim i mundshëm i emetimeve ndotëse në ujërat nëntokësore
<b>Toka dhe nëntoka</b>	Derdhje e substancave ndotëse
<b>Zhurmat dhe vibrimet</b>	Emetime akustike të mjeteve të kantierit Vibrimeve të makinerive në funksionim
<b>Trafiku i automjeteve</b>	Vështirësi në qarkullim
<b>Mbetjet</b>	Prodhim mbetjesh ndërtimore

Në vend të përkufizimeve të impakteve me karakter të përgjithshëm, këtu janë përcaktuar impaktet e lidhur me secilin aktivitet të kantierit. Për këtë qëllim, fillimisht është kryer përcaktimi i makroaktiviteteve, në të cilat mendohet ndarja e fazave të ndërtimit; secilit aktivitet i është bashkangjitur një klasë impakti mjedisor i pritshëm.





Lidhja aktivitet-impakt është bërë duke u nisur nga diferencimi i aktiviteteve dhe makinerive të përdorura në kantier sipas fazave të ndërtimit dhe duke i lidhur këto faza me impaktet mjedisorë të nxjerrë nga literatura teknike. Duke qenë se jemi akoma në fazën e projektimit, nuk është i mundur thellimi i mëtejshëm i problematikës përse i përket tipologjisë, numrit, mënyrës dhe ritmit të përdorimit të makinerive dhe logjistikës në përgjithësi në zonën e kantierit. Gjithashtu, duke patur parasysh mungesën e të dhënave lidhur me vendodhjen fizike të aktiviteteve të ndryshme, funksioneve dhe strukturave të instaluar në zonën e kantierit, udhëzimet e dhëna për zbutjen e ndikimeve mjedisorë që lidhen me fazën e kantierit, kanë një karakter të përgjithshëm.

Tabela 3 tregon makineritë të cilat përgjithësisht përdoren në fazat e ndryshme të punimeve, ndërsa Tabela 4 jep në formë matricore faktorët potencialë të impaktit lidhur me aktivitetet e ndryshme të fazës ndërtimore të infrastrukturës.

**Tabela 3. Përdorimi i makinerive gjatë aktivitetit të kantierit**

Nr.	Aktiviteti	Tipologjia e makinerive të përdorura
1.	Impianti i kantierit	Automjete për transportin e materialeve Mjete pune
2.	Gërmime dhe lëvizje dheu	Ekskavatorë
		Mjete mekanike
3.	Themele dhe vepra mbajtëse	Automjete
		Betoniera
		Ekskavatorë
		Mjete mekanike
		Automjete
		Stacione për realizimin e pilotave
4.	Sistemime të jashtme	Tyrjela
		Betoniera me sistem pompimi
		Pajisje të ndryshme (kompresorë, vibratorë, sharra, hekurkthyes, etj)
		Automjete
5.	Heqja e kantierit	Betoniera
		Stabilizues - nivelues
		Rula kompaktues
5.	Heqja e kantierit	Automjete
		Mjete mekanike

**Tabela 4. Faktorët potencialë të impaktit lidhur me fazën e kantierit**

MATRICA PËRMBLEDHËSE E IMPAKTEVE (FAZA E KANTIERIT)		AKTIVITETET E KANTIERIT	Impianti i kantierit	Gërmime dhe lëvizje dheu	Themele dhe vepra mbajtëse	Sistemime të jashtme	Heqja e kantierit	PROCESI I PËRGJITHSHËM
	Impakt potencial i lartë							
	Impakt potencial mesatar							
	Impakt potencial i ulët							
	Impakt potencial i neglizhueshëm							
<b>KOMPONENTËT MJEDISORË</b>								
Atmosfera	Emetime gazore							
	Pluhura							
Mjedisi ujor								
Toka dhe nëntoka								
Zhurmat dhe vibrimet	Zhurmat							
	Vibrimet							
Ndriçimi								
Peisazhi								
Trafiku i mjeteve								
	Lendë djegëse fosile							

Energjia	Energji elektrike						
	Burime të tjera energjitike						
Mbetjet	Të rikuperueshme						
	Jo të rrezikshme						
	Të rrezikshme						

Nga tabela përmbledhëse rezulton një kuadër pak a shumë jo problematik për sa u përket impakteve që krijohen nga kantieri.

### Atmosfera

Duke ju referuar komponentit atmosferë, ndikimet potenciale mjedisore gjatë fazës së kantierit janë ato të lidhura me prodhimin e pluhurave dhe emetimeve nga motorat e mjeteve të punës që do të përdoren. Duke patur parasysh vendodhjen e zonës (cf. figurën përkatëse), ky aspekt nuk do të ndikonte në mënyrë të tillë që të prishte cilësinë e ajrit për banorët e zonës.

Përsa u përket pluhurave, burimet më të mëdha të emetimeve do të jenë lëvizjet e dheut (gërmime dhe mbushje) të nevojshme për realizimin e strukturës së objektit dhe sistemimit të jashtëm. Gjithësesi, mundësia e ndikimit të erës në rritjen e sasisë së pluhurave pezull në ajër, duhet konsideruar, ndikim i cili është i paparashikueshëm në kohë dhe hapësirë.

### Zhurmat dhe vibrimet

Vlerësimet e kryera gjatë fazës paraprake kanë evidentuar se pozicioni i veçantë i zonës së kantierit në raport me kontestin mjedisor rrethues, bën të mundur thjeshtimin e vlerësimit të impakteve potencialë të komponentëve **zhurma** dhe **vibrime**.

Përsa u përket dukurive të përhapjes së vibrimeve, problematikat më të mëdha mund të shfaqen kryesisht për disa objekte të veçuar të pozicionuar pak a shumë në zonën e projektit. Gjithësesi, duke qenë se bëhet fjalë për punime të kufizuara në kohë dhe intensitet, ato nuk do të kenë efekte të ndjeshme mbi strukturat mbajtëse të objekteve.

Duke iu referuar problematikave akustike, analizat paraprake kanë treguar se zbutja e zhurmës si pasojë e distancës midis burimeve të zhurmës dhe receptorëve potencialë është e tillë që kontributi i emetimeve akustike në lidhje me banesat rezulton i tolerueshëm në krahasim me limitet normativë.

### Mbetjet

Përgjithësisht, menaxhimi i mbetjeve të një kantieri përbën një nga problemet më të rëndësishëm. Një menaxhim korrekt duhet të synojë në rikuperimin e të gjitha mbetjeve që mund të ripërdoren dhe reciklohen.

Të dhënat sasiore mbi mbetjet e prodhuara nga kantieri specifik në studim, mund të kihen vetëm në fazën e projektit të zbatimit. Përgjithësisht, gjithësesi një fraksion prej 70 % e totalit të mbetjeve të gjeneruara nga aktivitetet e shkatërrimit/ndërtimit/rikuperimit përbëhet nga mbetjet inerte të cilat, megjithëse kanë përmbajtje relativisht të ulët të ndotësave (përveç rasteve të ndotjeve specifike/përmbajtjes së substancave të rrezikshme) mund të krijojnë probleme serioze mjedisore për shkak të volumeve të prodhuar dhe mënyrës jo korrekte të eliminimit. Për këto mbetje, duhet parashikuar ripërdorimi i tyre në

sektorin e ndërtimit dhe rikuperimit mjedisor pas trajtimeve përkatëse (bluarje, përzgjedhje granulometrike dhe ndarje e fraksionit metalik dhe fraksioneve të lehta). Duke u nisur nga produkti i origjinës, materialet e ricikluara mund të ndahen në dy kategori të veçanta:

- Gërmadhat (tulla, qeramikë, kartonxhes, inerte, copa konglomeratesh betoni, etj) dhe betonet e ricikluar (copa konglomeratesh betoni të armuar të dalë nga shkatërrimet e veprave prej betoni, nga mbetjet e industrisë së prefabrikateve, traversinat hekurudhore prej b/a, etj);
- Materiale me prejardhje nga reciklimi i mbetjeve të aktiviteteve të shkatërrim/ndërtimit të cilët mund të konsiderohen të njëvlershëm me tokat e origjinës natyrore dhe përzjerjeve të agregateve natyrorë të bluar; ata mund të gjejnë përdorim në ndërtimin e rrugëve (bazamente, shtresa themeli, mbushje, shtresa të çimentuara, etj).

Për sa u përket mbetjeve inerte që do të gjenerohen gjatë fazës së prishjes së objektit ekzistues dhe ndërtimit, ato do të menaxhohen në bashkëpunim me një operator të licencuar të pajisur me licencë të kategorisë III.2.B “ Grumbullim dhe transportim të mbetjeve inerte ”, referuar Ligjit nr. 9010 datë 13.02.2003 “ Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta ” i ndryshuar me Ligjin nr. 10137, datë 11.05.2009 dhe VKM nr. 575, datë 24.6.2015 “ Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte ”. Operatori do të plotësojë dokumentat e transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme sipas Vendimit nr. 229, datë 23.04.2014 “ Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit ”.

Referuar Vendimit nr. 99, datë 18.02.2005 “ Për miratimin e Katalogut Shqiptar të Mbetjeve ”, mbetjet e gjeneruara mund të klasifikohen:

- 17 01 01      Beton
- 17 01 07      Përzjerje të betonit, tullave, tjegullave dhe qeramikës, të tjera nga ato të përmendura në 17 01 06
- 17 05 04      Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03
- 17 09 04      Mbetje të përziera nga ndërtimi dhe të prishjeve, të tjera nga ato të përmendura në 17 09 01, 17 09 02 dhe 17 09 03

Gjithashtu, është e mundur që një pjesë e mbetjeve të dherave që do të gjenerohen gjatë fazës së gërmimeve, të përdoret si stabilizant për shtresën e dyshemesë dhe për rehabilitimin e sipërfaqes së ndërtimit.

### **Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative**

Punimet ndërtimore mund të zgjasin për një periudhë 1 vjeçare. Kjo është koha normale që duhet për të përfunduar ndërtimin e objektit në kushte normale. Kjo periudhë është e vlefshme në kushte teknike, juridike e klime normale, por në rast se do të hasen vështirësi gjatë punimeve mund të ketë edhe shtyrje të afatit. Si rrjedhojë edhe ndikimet e fazës ndërtimore do të zgjasin për aq kohë sa zgjasin punimet përkatëse. Përsa u përket ndikimeve gjatë fazës së funksionimit, ato do të jenë prezente për aq kohë sa do të përdoret edhe objekti. Gjithashtu, si faktor vlerësohet edhe numri i automjeteve që do të qarkullojnë mbi rrugë. Këto ndikime nuk janë me rëndësi të veçantë në se krahasohen me të dhënat që

disponohen përpara rikonstruksionit të urës. Të gjitha ndikimet e mësipërme nuk janë të përhershme dhe afatgjata, ato janë të përkohshme dhe afatshkurtra. Ndikimi në peisazh do të jetë i përkohshëm për fazën e ndërtimit, dhe i përhershëm nga zënia e hapësirës dhe ndërtimi i strukturës së rrugës.

### **Shtrirja e mundshme hapësinore e ndikimit negativ në mjedis**

Ndikimi në mjedisin e zonës do të ketë efektet e tij në një distancë jo më të largët se 100 - 200 m.

Ky ndikim do të jetë i përkohshëm dhe nuk është me veti akumuluese në mjedis. Nuk shkarkohen elementë të demshëm për mjedisin, si atë ujor, atmosferën, tokën dhe biodiversitetin, përveç atyre të identifikuar në matricën e impakteve. Ndikimi në peisazh do të jetë i përkohshëm për fazën e ndërtimit, dhe i përhershëm nga ndërtimi i strukturave mbi tokë. Ky impakt shtrin efektet e tij deri në disa km.

### **Rehabilitimi i mjedisit dhe kthimi i tij në gjendjen e mëparshme**

Pas mbarimit të punimeve, do të bëhet demontimi i kantierit duke larguar dhe zhvendosur elementët e rrethimit dhe të kufizimit provizor të kantierit, pajisjet dhe sinjaletikën e përdorur. Më pas, do të procedohet me pastrimin përfundimtar të sheshit të ndërtimit. Kostoja financiare e të gjitha operacioneve do të përballohet nga firma zbatuese.

#### **9.4 MASAT ZBUTËSE KUNDËR IMPAKTEVE TË PRODHUAR NGA KANTIERI**

Më poshtë jepen masat zbutëse kundër impakteve të sugjeruara për komponentët mjedisorë kryesorë të interesuar.

**Tabela 5. Masat zbutëse - Atmosfera**

<b>Tipi i aktivitetit</b>	<b>Masat zbutëse</b>
<b>Trajtimi dhe lëvizja e materialeve</b>	Aglomerimi i pluhurit nëpërmjet lagies së materialit
	Përdorimi i proceseve me lartësi të ulët hedhjeje dhe shpejtësi të vogël
	Lagia e materialit në formë pluhuri përpara lëvizjes së tij
	Izolimi i zonave të punimeve për të kufizuar përhapjen e pluhurave
	Evitimi i djegies së mbetjeve të punimeve dhe/ose ambalazheve të cilat provokojnë emetim tymi dhe gazi
<b>Depozitimi i materialeve</b>	Lagia me ujë e grumbujve të materialeve prej copash të imta
	Marrja e masave mbrojtëse të përshtatshme për depozitimin e materialit të shkrifët
	Kufizimi i shpejtësisë maksimale brenda

<b>Zonat e qarkullimit brenda dhe jashtë kantierit</b>	pistave të kantierit (max. 20 km/h)
	Konsolidimi i përshtatshëm i pistave të transportit më të frekuentuara
	Lagia periodike e pistave të transportit
	Larja e rrotave përpara daljes nga kantieri
	Optimizimi i ngarkesave të transportuara
<b>Makineritë</b>	Përdorimi i makinerive të punës me emetime të ulta
	Përdorimi i sistemeve të filtrimit për thërmijat për makineritë/aparaturat me motorë diesel
	Mirëmbajtja periodike e makinerive dhe aparaturave

**Tabela 6. Masat zbutëse - Zhurmat**

<b>Lloji i masave</b>	<b>Masat zbutëse</b>
<b>Masa aktive</b>	Zgjedhje paraprake e makinerive dhe pajisjeve me performancë të lartë
	Mirëmbajtje e mjeteve dhe pajisjeve
	Vëmendje në kryerjen e punimeve dhe përgatitjen e kantierit
	Fikja e motorëve në rastin e pushimeve dhe fikja e pajisjeve në rastet e punimit bosh
<b>Masa pasive</b>	Kufizimi i përdorimit të motorëve në regjim të lartë xhirosh
	Krijimi i barrierave provizore kundër zhurmave në perimetrin e zonës së kantierit

**Tabela 7. Masat zbutëse - Mbetjet**

Objektivat	Masat zbutëse
<b>Menaxhimi i mbetjeve</b>	Ndarja e mbetjeve të rrezikshme nga mbetjet jo të rrezikshme
	Ndarja e tipeve të ndryshme të mbetjeve të rrezikshme dhe evakuimi i tyre nga një firmë e autorizuar duke kufizuar në maksimum qendrimin e tyre në kantier
	Marrja e masave të përshtatshme me qëllim evitimin e ndotjes në rastin e depozitimit të përkohshëm të mbetjeve të rrezikshme
	Verifikimi i mbylljes hermetike të amballazheve që përmbajnë mbetje të rrezikshme
	Mbledhja dhe stokimi i ndarë i të gjitha mbetjeve të rikuperueshme dhe dërgimi i tyre në impiantet e trajtimit
	Mbledhja dhe stokimi i ndarë i të gjitha mbetjeve të reciklueshme dhe jo të reciklueshme nga një firmë e autorizuar duke kufizuar në maksimum qendrimin e tyre në kantier
	Nënshkrimi i marrëveshjeve me furnitorët me qëllim rimarrjen e amballazheve përkatës dhe të materialeve difektozë eventualë
	Informimi i personelit lidhur me menaxhimin e mbetjeve të prodhuara në kantier

Lidhur me aktivitetet specifike të zhvilluara, gjithësesi duhen parashikuar dhe marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim evitimin ose minimizimin e emetimeve të ndotësave fizikë dhe kimikë (zhurma, pluhura, gaze, avuj, etj). Në rast se aktivitetet e zhvilluara kanë të bëjnë me përdorimin e makinerive dhe impianteve gjenerues të zhurmave, autorizimi i përdorimit të tyre duhet të jepet nga Autoriteti Lokal. Autorizimi duhet të përmbajë përcaktimin e orareve të punimeve për makineritë gjeneruese të zhurmave dhe përdorimin e barrierave kundër zhurmës.

## 9.5 FAZA OPERATIVE

Gjatë fazës së funksionimit të objektit, shkalla e aktiviteteve, niveli i trafikut etj, kanë pak gjasa të jenë mjaft të lartë në atë shkallë sa të shkaktojnë shqetësime në lidhje me zhurmat, ndotjen e ajrit dhe ujërave, duke bërë të mundur respektimin e limiteve të zonës për të tre këto aspekte.

### Zhurma

Impakti i zhurmave është i neglizhueshëm. Ai është i lidhur vetëm me nivelin e trafikut dhe të aktiviteteve që ndodhen rreth urës, nivele ekzistuese përpara menaxhimit të objektit.

### Ajri

Impaktet gjatë fazës operative janë të kufizuara vetëm me emetimet e lidhura me trafikun e shkaktuar nga automjetet që qarkullojnë në rrugën që limiton objektin ku do të ndërhyet.



## **Vibrimet**

Impakti i vibrimeve si pasojë e shfrytëzimit të objektit, nuk modifikon dukshëm gjendjen ekzistuese të vibrimeve që karakterizon aktualisht zonën e ndërtimit, dhe që në situata të ngjashme të dokumentuara me matje eksperimentale, nuk ka evidentuar situata kritike duke iu referuar limiteve të normativës.

## **Ujërat**

Gjatë fazës operative, sistemi i drenazhimit të ujërave atmosferike do të kryejë kolektimin dhe evakuimin e këtyre ujërave drejt kolektorit të rrugës dhe më pas drejt mjedisit receptor. Impakti mbi funksionimin e sistemit të evakuimit ekzistues të këtyre ujërave është i neglizhueshëm, pasi prurja e tyre është e vogël.

### **10. PASIGURITË NË VLERËSIMIN E NDIKIMIT**

Pasiguritë kryesore të vlerësimit të ndikimit lidhen me çështje të ndyshme që kanë të bëjnë me vende ndihmëse si sheshe bazë, vende për mbajtje agregatesh dhe sipërfaqe të prishura në dispozicion.

Pasiguritë lidhur me vendosjen e pikave ndihmëse të ndërtimit, shkalla e tyre dhe metodat e operimit do të mbeten të panjohura derisa kontraktuesi të jetë caktuar dhe të ketë bërë hollësitë e programit të punës së tij.

### **11. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I PERFORMANCËS MJEDISORE**

Natyra e projektit është e tillë që shumica e punimeve do të realizohen në renditjen e planifikuar, kështu që shmanget ose pakësohet shkalla e efekteve keqësuese.

Në fazën ndërtimore të projektit ndikimet keqësuese mund të zbuten kënaqshëm, ose me anën e projektimit të mirë inxhinierik, ose përmes adoptimit dhe përforcimit të kushteve mbrojtëse mjedisore në kontratat ndërtimore të tipi teknik, logjistik dhe organizativ. Megjithatë do të jenë të pranishëm rreziqet e sigurisë rrugore në rritje me shpejtësinë e madhe të automjeteve dhe volumin më të madh të trafikut gjatë operimeve.

### **12. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR (PMM)**

#### **PMM do të përmbajë:**

- Vlerësimin e impakteve mjedisore të parashikuara në faza të ndryshme, veçanërisht gjatë ndërtimit, funksionimit (përfshirë mirëmbajtjen) dhe dekomisionimit, periudhat kohore gjatë të cilave do të kryen fazat e mësipërme, shkallën e tyre, qëllimin dhe pasojat;
- Përcaktimin e nivelit të pranueshëm të secilit impakt, veçanërisht në lidhje me periudhën kohore, zgjatjen në kohë, shkallën, pasojat, kostot, dhe nivelet e lejuara ligjore;
- Kushtet dhe masat që duhen ndërmarrë për të zbutur këto impakte në çdo fazë, cilët do të jenë përgjegjës për to, nëse duhet përmirësuar projekti teknik, ose nëpërmjet

masave mbrojtëse gjatë ndërtimit, apo metoda të tjera, kostot e mundshme, implikimet për përfundimet e projektit, etj;

- Burimet dhe metodat e kërkuara për monitorimin, matjen dhe vënien në zbatim të tyre (çfarë është për t'u matur, kur dhe ku, nga kush dhe pse), përgjegjësitë institucionale për secilin veprim dhe kërkesat e nevojshme për ngritjen e kapaciteteve, dhe kostot përkatëse të secilit element.

PMM do të përmbajë dy dokumente të veçanta: një Plan Zbutës, që merret me aspektet e përshkruara më sipër dhe një Plan Monitorues. Pritet që të përgatiten në kohën e finalizimit të përfundimit të projektit teknik dhe duhet të përmbajnë të gjitha kërkesat e specifikuara në Vendimin Paraprak të VNM të lëshuar nga AKM.

Bashkia ose propozuesit (nëse nuk janë të njëjtë) do të jenë përgjegjës për përgatitjen e PMM. Megjithatë në Termat e Referencës së projektuesit të projektit përfshihet përgatitja e PMM. Aty ku nënprojekti kërkon një VNM, do të kërkohe mendimi i specialistëve të VNM para se ky i fundit të finalizohet.

### **13. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMEVE GJATË FAZËS SË KANTIERIT**

#### **Qëllimet e monitorimit mjedisor**

Monitorimi për parametrat që kërkohe bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

#### **Objektivat e Monitorimit:**

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë ndërtimit;
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimit të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE;
- Të përcaktojë në se ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin e projektit dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me projektin e propozuar;
- Të përcaktojë efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të projektit;
- Të përcaktojë impaktet afatgjatë (nëse ka);
- Të përcaktojë zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajonin e projektit, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të;
- Të krijojë një arkivë të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen;

- Të garantojë përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për t'u përdorur për një qëllim të caktuar.

#### 14. BAZA LIGJORE E MONITORIMIT

Monitorimi i mjedisit është detyrim ligjor. Mënyra, frekuenca dhe elementët e monitorimit janë të ndryshëm për veprimtari të ndryshme.

##### Kërkesa ligjore bazë për kryerjen e monitorimit

Ligji nr. 10431, datë 09.06.2013 “ Për mbrojtjen e mjedisit ”, Kreu VI, “ Monitorimi i gjendjes së mjedisit ” përcakton:

*Subjekti është i detyruar të kryejë monitorimet periodike sipas kërkesave të përcaktuara në kushtet e Vendimit Paraprakt të VNM.*

Baza ligjore për monitorimin jepet e përmbledhur në vijim:

Ligji/VKM/Udhëzimi	Subjekti
<b>Ligji nr.10266, datë 15.04.2010</b>	Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
<b>Ligji nr. 9774, datë 12.07.2007</b>	Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis
<b>VKM nr.1189, datë 18.11.2009</b>	Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit
<b>VKM nr. 103, datë 31.03.2002</b>	Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë
<b>VKM nr. 435, datë 12.09.2002</b>	Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë
<b>VKM nr. 803, datë 04.12.2003</b>	Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit
<b>Udhëzim nr.8, datë 27.11.2007</b>	Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara
<b>Udhëzim nr. 6527, datë 24.12.2004</b>	Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkarkuar nga mjetet rrugore, dhe mënyra e kontrollit të tyre, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 12, datë 15.06.2010

Rekomandohet monitorimi i këtyre elementëve:

Nr.	Monitorimi	Parametrat që do të monitorohen	Periudha kohore	Frekuenca	Përgjegjësia
1	Cilësia e ajrit	PM10, SO <sub>2</sub> , NO <sub>x</sub> , CO, CO <sub>2</sub> , HC	Nga fillimi i projektit deri në përfundimin	Çdo 6 muaj	Eksperti mjedisor

			e tij		
2	<b>Emetimi i zhurmave</b>	Niveli i zhurmave në dB	Nga fillimi i projektit deri në përfundimin e tij	Çdo 6 muaj	Eksperti mjedisor
3	<b>Monitorimi i shpejtësisë maksimale të valës zanore</b>		Nga fillimi i projektit deri në përfundimin e tij	Çdo 6 muaj	Eksperti mjedisor
4	<b>Rastet, incidentet e mundshme në vendin e punës</b>	Regjistrimi dhe raportimi i mënyrës së trajtimit	Nga fillimi i projektit deri në përfundimin e tij	Çdo 3 muaj	Oficeri i Sigurisë
5	<b>Avari apo defekte të ndryshme të mundshme gjatë operimit</b>	Regjistrohen, raportohen	Nga fillimi i projektit deri në përfundimin e tij	Çdo 3 muaj	Oficeri i Sigurisë dhe Drejtuesi i Punimeve
6	<b>Dëmtim i vegjetacionit</b>	Regjistrohen	Nga fillimi i projektit deri në përfundimin e tij	Çdo 6 muaj	Eksperti mjedisor
7	<b>Monitorimi i zbatimit të kushteve të Vendimit Paraprak të VNM</b>	Monitorohen, regjistrohen, raportohen	Nga fillimi i projektit deri në përfundimin e tij	Çdo 6 muaj	Eksperti i mjedisor & inspektoriati përkatës

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokës, shkarkimeve urbane etj, kryhet sipas disa kriterëve shkencore përta i përket monitorimeve, mbledhjes dhe analizave të mostrave. Ai synon në mbledhjen e të dhënave për të vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit antropik dhe natyror në ndryshimet e mjedisit, ku ai është aktiv.

Objektivat kryesore të monitorimit janë:

- Zbulimi i ndryshimeve dhe karakterizimi saktësisht nga ana sasiore i tendencave (prirjeve) në përdorimin e burimeve.
- Sigurimi i informacioneve mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) të burimeve dhe shkaqeve të tyre.
- Evidentimi i cilësisë së mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor, me synim për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e tyre.
- Vlerësimi i efektivitetit të politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve natyrore.

Monitorimi është detyrë e shoqërisë investitore në nivel individual për pikat ç1, ç2, ç5, ç6, ç7, ç8 të Vendimit nr. 1189, datë 18.11.2009 “ Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë ”

Investitori do të monitorojë këto tregues të trysnisë në mjedis vetëm gjatë fazës së kantierit:

- Për ajrin lëndën e ngurtë pezull (LNP) dhe zhurmat (dB);
- Për ujën, shkarkimet nga larja e makinerive/pajisjeve;

Frekuenca e monitorimeve do të përcaktohet në aktin e miratimit të Vendimit Paraprak të VNM dhe në rast të kundërt, sipas kuadrit ligjor sipas të cilit çdo 6 muaj të kryhen matjet dhe çdo 3 muaj të dorëzohet një relacion periodik i shkurtër ku të pasqyrohen punimet e kryera të shoqëruara me foto.

## 15. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

- Të zbatohet projekti i ndërtimit dhe përdorimi i materialeve cilësore për të krijuar një pamje estetike të integruar të objektit me elementë të zonës;
- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë dekorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit;
- Të shmanget në maksimum përdorimi i gjeneratorit dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona;
- Të kryhet lagia e sipërfaqeve të gërmuara dhe me inerte, si dhe të rrugëve komunikuese.
- Të kryhet rrethimi i kantierit të ndërtimit gjatë punimeve dhe të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit;
- Të kryhet larja e automjeteve para daljes së tyre në rrugët e asfaltuara të zonës;
- Të reduktohet qarkullimi në orët e pikut të trafikut, për të mos krijuar trafik të rënduar në zonë;
- Të mos përdoren boritë e mjeteve në qendrat e banuara dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulët;
- Të vendosen postera sensibilizues për punonjësit dhe vizitorët për një mjedis të pastër;
- Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Vendimin Paraprak të VNM që do të miratohet nga AKM;
- Subjekti të respektojë të gjitha masat e percaktuara në këtë raport të VNM;
- Subjekti të jetë në dijeni të kuadrit ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij;
- Të kryhet monitorimi i mjedisit sipas ligjeve në fuqi;
- Si rezultat i realizimit të projektit nuk do të gjenerohen ndikime të rëndësishme mjedisore dhe sociale në shëndetin e njerëzve. Për pasojë ndikimet e parashikuara mund të minimizohen duke zbatuar masat e përmendura më sipër;
- Të respektohet destinacioni i përcaktuar për ndërhyrjet në territor konform PPV dhe PDV të Njësisë Vendore, konform rregullores mbi intensitetin e ndërtimit dhe koeficientin e shfrytëzimit të tokës;
- Ndikimet do të jenë kryesisht të përkohshme dhe jo të përhershme;
- Për ndikimet e identifikuara janë propozuar masat përkatëse me qëllim minimizimin dhe eliminimin e këtyre impakteve;

- Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social;
- Është detyrë e Njesisë Administrative Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit;
- Është detyrë e të gjithë kontraktorëve dhe nënkontraktorëve të ndryshëm që gjatë fazës së ndërtimit të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.